



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:282833  
Datë: 21.02.2024  
Numri i dokumentit: 05350973

**AA.nr.542/2023**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** -Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Hajriz Hoti dhe Delushe Halimi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses Z.G, Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson Ekrem Agushi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2228/2019 të datës 27.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2023, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditëses Z.G, Komuna e Suharekës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2228/2019 i datës 27.04.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2228/2019 të datës 27.04.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadija e paditëses, Z.G, Komuna e Suharekës, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi i të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS-DAP) në Prishtinë, Nr. 05-02/2573 të datës 28.08.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditëses, avokat Ekrem Agushi, nga Prishtina për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, ankesën e paditësit ta aprovoj dhe ta miratoj si të bazuar dhe aktgjykimi ankimor të prishet dhe çështja ti kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë - Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, me vendimin me nr. të dosjes 05-02/2573 të datës 28.08.2019, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e Z.G, me të cilin ka kërkuar që ti njihet e drejta për pension të skemës invalid civil i luftës.

Paditësja e pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë -Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 23.09.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet si i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër vendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë -Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, të datës 28.08.2019, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të lartcekur të paditurës. Me arsyetim se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 43.3 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpapia e paditëses është e pabazuar. Paditësja me datën 03.05.2011 ka parashtruar kërkesa tek e paditura Departamenti të Familjeve të Dëshmoreve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile për njohjen e të drejtës në pension Invalid Civil të Luftës. Me vendimin e organit të shkallës së parë është refuzuar ankesa e paditëses për njohjen e të drejtës për pension të skemës Invalid Civil të Luftës. Gjykata e shkallës së parë duke aprovuar propozimin e paditëses, për nxjerrjen e provës me ekspertizë, ka obliguar QKUK-në që të caktojë ekspertët mjekësor të cilët do të hartonin ekspertizën mjekësore në bazë të dokumentacionit dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditëses. Gjykata e shkallës së parë në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27 prill 2023, ka ftuar ekspertët mjekësor, me ç'rast ekspertët, kanë sqaruar ekspertizën mjekësore duke u përgjigjur në pyetjet e gjykatës dhe të paditëses. Në bazë të ekspertizës së datës 19.01.2023 si dhe deklaratimit të ekspertëve mjekësor Dr. M.K – psikiatër, Dr.S.D - Ortoped, Dr.Sh.D - Kirurg Torakal, në seancën e datës 27 prill 2023, vërtetohet se paditësja ka lëndimet trupore të shkaktuara me armë zjarri në regjionin e shpatullës dhe krahut të djathtë. Po ashtu, në bazë të ekspertëve mjekësor tek paditësja ende janë prezentë plagët eksplozive në regjionin e shpinës të shoqëruara me parasteziona dhe dhembje në regjionin e gjoksit e shoqëruara dhe si pasojë e këtyre lëndimeve trupore të shkaktuara me armë eksplozive në regjionet e lartcekura, tek paditësja ekziston stresi posttraumatik dhe zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 25%. Me nenin 14 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës përcaktohet si në vijim: *“Të drejtën në pensionin invalidor civil të luftës e realizojnë invalidët civil të luftës me shkallë të invaliditetit prej 40% - 100%”*. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësja nuk i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara më lartë që shkalla e invaliditetit të jetë më së paku 40% në mënyrë që e njëjta të mund të jetë përfituese e këtij pensioni. Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet e paditëses, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe

nga ana e organit të shkallës së parë dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Padiësja nuk dëshmon pretendimet e saj, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata e shkallës së parë konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses, andaj gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditëses sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organeve administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 43 par.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitës ligjore 14 par.1 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës me të cilin përcaktohet se: *“Të drejtën në pensionin invalidor civil të luftës e realizojnë invalidët civil të luftës me shkallë të invaliditetit prej 40% - 100%”*.

Sa i përket pretendimeve ankimore për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, ky kolegji këto pretendime nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike se gjykata e shkallës së parë e ka shkelur parimin e ligjshmërisë dhe barazisë së palëve kur ia ka falë besimin mendimit të ekspertëve të të paditurës andaj ky fakt rrjedh se mendimi i mjekëve të paditurës në këtë çështje ka qenë i njëanshëm., padiësja konsideron se vendimi i organit të paditur është i kundërligjshëm nuk mund të qëndroj për arsye se mendimi i Komisionit Mjekësor i shkallës së parë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë dhe profesional të lëndimeve trupore dhe pasojave shëndetësore sepse ekziston zvogëlimi i aftësisë së përhershme jetësore, si shkak i zvogëlimit të aktivitetit mjekësor ashtu që është konstatuar që padiësja nuk mund të kryej punët e shtëpisë dhe veprimet e tjera fiziologjike, krejt këto që paditëses gjithnjë i duhet përkujdesje e personit të tretë, pasi që pasojat jetësore të paditëses sa vjen e zvogëlohen. Po ashtu se komisioni Mjekësor i Shkallës së parë nuk e ka bërë vlerësimin e drejtë dhe profesional të lëndimeve trupore dhe pasojave shëndetësore sepse ekziston zvogëlimi i aftësisë së përhershme jetësore si shkak i plagosjes së rëndë në periudhën e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 në pjesën e sipërme të kraharorit e cila në bazë të dokumentacionit mjekësorë të lëshuar nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Malishevë Nr.C.F/49 i datës 31.04.2011 vërtetohet se padiësja është plagosur nga forcat serbe me dt. 04.06.1999, gjithashtu edhe në bazë të raportit dhe diagnozës së mjekut specialist F.S ekstraktit nga dokumentacioni arkivor me diagnoz të dt. 04.04.2011 që ka konstatuar se padiësja nuk mund të kryej punët e shtëpisë dhe veprimet e tjera pa ndihmën e fëmijëve djemve dhe bashkëshortit, krejt kjo që paditëses gjithnjë i duhet përkujdesje e personit të tretë, pasi që pasojat jetësore të paditëses sa vijnë e zvogëlohen si pasoj e plagosjes nga periudha e luftës. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate vlerëson se janë të pa bazuara, për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditëses ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditëses janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme. Ngase, gjykata kishte aprovuar propozimin e përfaqësuesit të paditëses për nxjerrjen e provës me ekspertizë mjekësore, në

bazë të ekspertizës së datës 19.01.2023 si dhe deklaramit të ekspertëve mjekësor Dr. M.K – psikiatër, Dr.S.D - Ortoped, Dr.Sh.D - Kirurg Torakal, në seancën e datës 27 prill 2023, vërtetohet se paditësja ka lëndimet trupore të shkaktuara me armë zjarri në regjionin e shpatullës dhe krahut të djathtë. Po ashtu, në bazë të ekspertëve mjekësor tek paditësja ende janë prezentë plagët eksplozive në regjionin e shpinës të shoqëruara me parasteziona dhe dhembje në regjionin e gjoksit e shoqëruara dhe si pasojë e këtyre lëndimeve trupore të shkaktuara me armë eksplozivë në regjionet e lartcekura, tek paditësja ekziston stresi posttraumatik dhe zvogëlim i aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 25%. Andaj mbi bazën e këtyre rrethanave del se paditësja nuk i ka plotësuar kushtet për realizimin e të drejtës për pension të skemës: invalid civil i luftës, dhe pranë një gjendje të tillë faktike, kolegji i kësaj gjykate konsideron se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kurse sa i përket pretendimeve tjera ankimore se për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë ka aplikuar gabimisht edhe të drejtën materiale. Kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pabazuara të paqëndrueshme dhe të paargumentuara me prova konkrete të cilat do të gjenin mbështetje ligjore dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
AA.nr.542/2023 me datë 14.02.2023

**Kryetari i kolegjit,**  
Ramiz Kuqi